

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje materiale izolimi”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 44111000-1, 45320000-6

Vlera e fondit limit: 1 666 560 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik. Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke shmangur ngarkesën administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe verifikuar dokumentacionin

provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet të paraqesi vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiarë për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

- SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

Certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizma akreditues ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili OE duhet të paraqesë certifikatat ISO të mësipërme.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjën mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Certifikimi sipas SSH EN ISO 9001 lidhet me aftësinë e operatorit ekonomik për të zbatuar procese të kontrolluara të menaxhimit të cilësisë, përfshirë kontrollin e furnizimit, identifikimin dhe gjurmueshmërinë e produkteve, kontrollin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat teknike, trajtimin e

produkteve jo-konforme dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së produkteve të furnizuara. Për një objekt që përfshin materiale izolimi dhe materiale të destinuara për përdorim në mirëmbajtjen dhe izolimin e çative, kontrolli i cilësisë është i rëndësishëm për të siguruar që produktet e furnizuara përputhen me karakteristikat dhe parametrat teknikë të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

Certifikimi sipas SSH EN ISO 14001 lidhet me sistemin e menaxhimit të aspekteve mjedisore të veprimtarisë së operatorit ekonomik. Kërkesa justifikohet nga nevoja për një qasje të kontrolluar ndaj ndikimeve mjedisore që mund të lidhen me furnizimin, magazinimin, transportin dhe menaxhimin e materialeve, si dhe me përdorimin dhe trajtimin e produkteve dhe ambalazheve të tyre. Zbatimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor kontribuon në identifikimin dhe kontrollin e aspekteve mjedisore dhe në respektimin e kërkesave përkatëse ligjore dhe rregullatore.

Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme dhe të jenë lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizma akreditues ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, synon të sigurojë që certifikimi i paraqitur të jetë i lëshuar nga një subjekt kompetent dhe i akredituar për aktivitetin përkatës të certifikimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa për paraqitjen e certifikatave nga secili operator ekonomik synon të sigurojë që çdo subjekt që merr pjesë drejtpërdrejt në realizimin e kontratës dhe në aktivitetet përkatëse të furnizimit të operojë sipas sistemeve të kërkuara të menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, një nga dokumentet e mëposhtme:

- *autorizim të prodhuesit; ose*
- *marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin; ose*
- *autorizim të distributorit të autorizuar për tregtimin e produktit në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Në rast se operatori ekonomik paraqet autorizim të lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të paraqitet gjithashtu dokumentacioni që provon marrëdhënien e autorizuar ndërmjet distributorit dhe prodhuesit, konkretisht marrëveshja ose dokumenti përkatës i autorizimit ndërmjet tyre.

Dokumentet e paraqitura duhet të identifikojnë qartë prodhuesin, produktin dhe subjektin e autorizuar, si dhe të përmbajnë të dhënat e kontaktit të prodhuesit, të tilla si: adresë, telefon, e-mail dhe website, nëse disponohen, me qëllim mundësimin e verifikimit të dokumentacionit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë, për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, autorizim të prodhuesit, marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin ose autorizim nga një distributor i autorizuar, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe karakteristikat e këtij produkti, si dhe nevojën për të garantuar një burim të identifikueshëm dhe të verifikueshëm furnizimi.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon një marrëdhënie të dokumentuar me prodhuesin ose me një subjekt të autorizuar prej tij për tregtimin e produktit, duke mundësuar

verifikimin e origjinës së produktit, zinxhirit të furnizimit dhe të drejtës për ta tregtuar atë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kërkesa është veçanërisht e lidhur me artikullin nr. 1, për të cilin specifikimet teknike përcaktojnë kërkesa të caktuara lidhur me karakteristikat, mënyrën e aplikimit dhe performancën e materialit. Dokumentacioni i autorizimit krijon mundësi për identifikimin e qartë të prodhuesit, produktit dhe subjektit që e furnizon ose e tregon atë, si dhe për verifikimin e informacionit të paraqitur nga operatori ekonomik.

Në rastin e autorizimit të lëshuar nga një distributor, kërkesa për paraqitjen e dokumentit që provon marrëdhënien e autorizuar ndërmjet distributorit dhe prodhuesit synon të sigurojë gjurmueshmërinë e zinxhirit të furnizimit dhe të mundësojë verifikimin e legjitimitetit të autorizimit të paraqitur.

Kërkesa për përfshirjen e të dhënave të kontaktit të prodhuesit, si adresa, telefoni, e-maili dhe website-i, kur disponohen, ka për qëllim lehtësimin e verifikimit të dokumentacionit nga Autoriteti Kontraktor dhe rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së burimit të produktit.

Ky kriter lidhet vetëm me artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama” dhe synon të mbështesë sigurinë e furnizimit dhe gjurmueshmërinë e produktit, ndërsa përputhshmëria e produktit me kërkesat teknike dhe standardet përkatëse vlerësohet nëpërmjet dokumentacionit teknik dhe të konformitetit të kërkuar në kriteret përkatëse.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog, broshurë, fletë teknike të produktit (Technical Data Sheet – TDS), ose fragmente/faqe të katalogut apo dokumentacionit teknik të lëshuar nga prodhuesi, për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”. Dokumentacioni teknik duhet të identifikojë qartë produktin e ofruar dhe të pasqyrojë karakteristikat dhe parametrat teknikë të kërkuar në specifikimet teknike. Parametrat teknikë përkatës duhet të jenë të evidentuar qartë dhe të dallueshëm në dokumentacionin e paraqitur, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë përputhshmërinë e produktit të ofruar me kërkesat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet

e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; ”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut, broshurës, fletës teknike të produktit (Technical Data Sheet – TDS), ose fragmenteve/faqeve të katalogut apo dokumentacionit teknik të lëshuar nga prodhuesi, për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë në mënyrë objektive dhe të dokumentuar përputhshmërinë e produktit të propozuar me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me blerjen e materialeve të izolimit, karakteristikat teknike të materialeve bituminoze janë të rëndësishme për përcaktimin e përshtatshmërisë së tyre për përdorimin e synuar, veçanërisht për sa i përket përbërjes, mënyrës së përdorimit, vetive teknike, kushteve të aplikimit dhe performancës së produktit. Për këtë arsye, është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të ketë në dispozicion dokumentacion teknik të burimit të prodhuesit, i cili paraqet të dhëna konkrete dhe të verifikueshme mbi produktin e ofruar.

Kërkesa që dokumentacioni teknik të identifikojë qartë produktin e ofruar synon të shmangë paraqitjen e dokumenteve të përgjithshme që nuk mund të lidhen me produktin konkret të ofertuar. Ndërkohë, kërkesa që parametrat teknikë të jenë të evidentuar qartë dhe të dallueshëm mundëson kryerjen e një verifikimi të drejtpërdrejtë nga Autoriteti Kontraktor, duke krahasuar të dhënat e deklaruara nga prodhuesi me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Përcaktimi i alternativave “katalog, broshurë, TDS, ose fragmente/faqe të katalogut apo dokumentacionit teknik” siguron fleksibilitet për operatorët ekonomikë, pasi nuk kushtëzon paraqitjen e një forme të vetme dokumentacioni, por lejon përdorimin e dokumenteve teknike të prodhuesit në formatin në të cilin ato disponohen. Në këtë mënyrë, kriteri synon të sigurojë informacionin teknik të nevojshëm për vlerësimin e produktit, pa vendosur një kërkesë që lidhet me një prodhues, markë apo burim të caktuar.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe natyrën e materialeve që do të prokurohen, pasi verifikimi i karakteristikave të produktit përpara kontraktimit është i nevojshëm për të garantuar që materiali i ofruar përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor dhe është i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Kriteri i mundëson Autoritetit Kontraktor të kryejë një vlerësim të bazuar në të dhëna objektive dhe të dokumentuara, duke reduktuar pasigurinë lidhur me karakteristikat e materialit të ofruar dhe duke garantuar që produkti që do të furnizohet përputhet me nevojat teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmërinë e produktit të ofruar për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama” me standardet, normat teknike dhe/ose referencat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata dhe/ose deklarata konformiteti dhe/ose deklarata performance, sipas rastit, të lëshuara nga prodhuesi dhe/ose nga institucione të pavarura

të akredituara, të cilat dëshmojnë përputhshmërinë e produktit/modelit të ofruar me standardet, normat dhe referencat teknike të kërkuara në shtojcën e specifikimeve teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave dhe/ose deklaratave të konformitetit dhe/ose deklaratave të performancës, sipas rastit, për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurojë dhe të verifikojë në mënyrë të dokumentuar përputhshmërinë e produktit të ofruar me standardet, normat teknike dhe referencat teknike të përcaktuara në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Duke qenë se objekti i prokurimit është “Blerje materiale izolimi”, produktet bituminoze përbëjnë materiale që përdoren për realizimin e funksioneve të izolimit dhe mbrojtjes së sipërfaqeve dhe strukturave. Për këtë arsye, përmbushja e kërkesave teknike dhe e standardeve të përcaktuara është e rëndësishme për të garantuar që materiali i furnizuar ka karakteristikat dhe nivelin e performancës të nevojshëm për përdorimin e parashikuar.

Dokumentet e kërkuara në këtë kriter synojnë të ofrojnë evidencë objektive dhe të verifikueshme mbi konformitetin e produktit të ofertuar. Nëpërmjet certifikatave, deklaratave të konformitetit ose deklaratave të performancës, Autoriteti Kontraktor mund të kontrollojë nëse produkti/modeli konkret i propozuar përmbush standardet dhe parametrat teknikë të përcaktuar në specifikimet teknike dhe nëse të dhënat e deklaruara për produktin mbështeten në dokumentacionin përkatës.

Përcaktimi i alternativave “certifikata dhe/ose deklarata konformiteti dhe/ose deklarata performance” sipas rastit është bërë me qëllim që kërkesa të jetë proporcionale me natyrën e produktit dhe me dokumentacionin që prodhuesi mund të lëshojë për produktin konkret. Në këtë mënyrë, nuk kushtëzohet operatori ekonomik me paraqitjen e një dokumenti të vetëm të përcaktuar paraprakisht, por i jepet mundësia të paraqesë dokumentin përkatës që provon konformitetin ose performancën e produktit sipas standardit apo referencës teknike të kërkuar.

Kërkesa që dokumentet të jenë të lëshuara nga prodhuesi dhe/ose nga institucione të pavarura të akredituara, sipas rastit, synon të sigurojë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e informacionit teknik të paraqitur. Në rastet kur dokumentacioni teknik lëshohet nga një organ i pavarur i akredituar, ai shërben si një burim i jashtëm dhe objektiv për verifikimin e karakteristikave dhe konformitetit të

produktit, ndërsa dokumentacioni i prodhuesit mund të përdoret për ato deklarime teknike që sipas natyrës së produktit dhe standardit përkatës deklarohen nga vetë prodhuesi.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me artikullin konkret për të cilin kërkohet, pasi synon të verifikojë jo thjesht ekzistencën e një produkti në treg, por përputhshmërinë e produktit të ofruar me kërkesat teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktor. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të kryejë një vlerësim të dokumentuar dhe të njëtrajtshëm të ofertave, mbi bazën e të dhënave teknike të produktit.

Kriteri nuk përcakton një prodhues, markë apo burim të caktuar dhe nuk kufizon mënyrën se si operatori ekonomik siguron produktin, por kërkon vetëm që produkti i propozuar të jetë i dokumentuar si konform kërkesave teknike të procedurës.

Në këtë kuadër, kriteri shërben si një mekanizëm verifikimi për të garantuar që produkti i ofruar për artikullin nr. 1 “Emulsion bitumi dhe 1K katrama” përmbush standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe, në këtë mënyrë, që materiali i furnizuar të jetë i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar në kuadër të kontratës së furnizimit.

2.3.6 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostër të artikullit nr. 1 e cila duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën “Specifikimet Teknike” të DST-së. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Eko Muzeu, Himarë fshat, Himarë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Kërkesa për paraqitjen e një mostre të artikullit nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund të kryejë një verifikim konkret të produktit të ofruar, përkundrejt kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Duke qenë se objekti i prokurimit është “Blerje materiale izolimi”, është e rëndësishme që produkti i ofertuar të jetë i përshtatshëm për përdorimin e synuar dhe të përputhet me karakteristikat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Për materialin “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, paraqitja e mostrës mundëson verifikimin e drejtpërdrejtë të produktit konkret që operatori ekonomik propozon të furnizojë dhe krijon mundësi për krahasimin e tij me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. Paraqitja e mostrës shërben si një element plotësues i dokumentacionit teknik të kërkuar në kriteret e tjera të kualifikimit. Ndërsa katalogët, fletët teknike, deklaratat e konformitetit apo dokumentet e tjera teknike japin të dhëna të dokumentuara mbi karakteristikat dhe performancën e produktit, mostra i mundëson Autoritetit Kontraktor të identifikojë dhe të kontrollojë produktin konkret të ofruar, duke shmangur paqartësitë që mund të lindin vetëm nga përshkrimi dokumentar i tij.

Kërkesa që mostra të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën “Specifikimet Teknike” siguron që të gjithë operatorët ekonomikë të vlerësohen mbi të njëjtat kërkesa dhe mbi të njëjtat karakteristika teknike të përcaktuara paraprakisht. Në këtë mënyrë, kriteri nuk vendos kërkesa subjektive për vlerësimin e mostrës, por e lidh verifikimin e saj drejtpërdrejt me specifikimet teknike të bëra të njohura në Dokumentet e Tenderit.

Përcaktimi i momentit të paraqitjes së mostrës në ditën dhe orën e hapjes së ofertave synon të sigurojë që produkti i paraqitur të jetë i identifikueshëm dhe i disponueshëm që në fazën e vlerësimit të ofertave. Kjo krijon mundësi që Autoriteti Kontraktor të verifikojë në mënyrë të njëtrajtshme mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe të dokumentojë rezultatet e këtij verifikimi në përputhje me kërkesat e procedurës.

Kërkesa për mostër është vendosur vetëm për artikullin nr. 1 – “Emulsion bitumi dhe 1K katrama”, për të cilin verifikimi konkret i produktit është i rëndësishëm për përcaktimin e përputhshmërisë së tij me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor. Në këtë mënyrë, kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me karakteristikat e materialit që do të furnizohet.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike të përcaktuara për materialet objekt prokurimi janë hartuar duke marrë në konsideratë funksionin, kushtet e përdorimit, kërkesat për qëndrueshmëri dhe nevojën për sigurimin e cilësisë së punimeve të izolimit dhe mirëmbajtjes së çatave.

Materialet do të përdoren për ndërhyrje mirëmbajtjeje dhe riparimi në elemente të çatave, ku cilësia dhe përshtatshmëria e materialeve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e konstruksioneve nga lagështira dhe ujërat atmosferike, si dhe në jetëgjatësinë e ndërhyrjeve.

1. Emulsion bitumi dhe 1K katrama: Kërkesa për material bituminoz të përshtatshëm për hidroizolimin e çatave lidhet me nevojën për krijimin e një barriere hidroizoluese të vazhdueshme, e cila kufizon depërtimin e ujit dhe lagështirës në shtresat e konstruksionit të çatisë. Parametrat e përcaktuar për trashësinë dhe peshën e membranës synojnë të sigurojnë një material me rezistencë dhe performancë të përshtatshme për përdorim në çati, duke ruajtur njëkohësisht fleksibilitetin e nevojshëm për t’iu përshtatur lëvizjeve të zakonshme të bazamentit dhe ndryshimeve të temperaturës. Kërkesa që materiali të jetë elastik, homogjen dhe pa çarje apo deformime është e nevojshme për të shmangur dobësimin e shtresës hidroizoluese dhe krijimin e pikave të mundshme të depërtimit të ujit. Përcaktimi i aplikimit me termosaldim me flakë dhe kërkesa për realizimin korrekt të mbivendosjeve synojnë të sigurojnë vazhdimësinë dhe papërshkueshmërinë e sistemit hidroizolues, veçanërisht në bashkimet ndërmjet fletëve të materialit.

2. *Ulluk shkarkimi PVC 33 cm*: Ulluqet janë pjesë funksionale e sistemit të çatisë, pasi sigurojnë mbledhjen dhe largimin e kontrolluar të ujërave të reshjeve nga sipërfaqja e çatisë. Përdorimi i PVC-së së përshtatshme për ambiente të jashtme lidhet me nevojën për një material që të përballojë ekspozimin ndaj lagështirës, rrezatimit UV, ndryshimeve të temperaturës dhe kushteve atmosferike. Kërkesa për elemente pa çarje, deformime dhe dëmtime synon të shmangë rrjedhjet dhe humbjen e funksionalitetit të sistemit të shkarkimit. Në mënyrë të veçantë, kërkesa që lidhjet ndërmjet segmenteve të sigurojnë papërshkueshmëri nga uji është e nevojshme për të parandaluar rrjedhjet në pikat e bashkimit, të cilat mund të shkaktojnë lagështim dhe dëmtime të elementeve të çatisë dhe të fasadës. Dimensioni 33 cm përcaktohet në funksion të nevojave të sistemit ekzistues dhe kapacitetit të kërkuar për mbledhjen dhe largimin e ujërave të reshjeve.

3. *Tjegulla marselieze*: Tjegullat qeramike parashikohen për përdorim si elemente të mbulesës së çatisë dhe kanë funksionin e mbrojtjes së konstruksionit nga reshjet atmosferike dhe depërtimi i ujit. Kërkesa për njëtrajtshmëri në formë dhe dimensione është e nevojshme për të siguruar vendosje të rregullt dhe mbivendosje korrekte të elementeve, ndërsa mungesa e çarjeve, thyerjeve dhe deformimeve është e domosdoshme për të shmangur pikat e depërtimit të ujit dhe dëmtimin e mbulesës. Rezistenca ndaj ngricës, lagështirës dhe ndryshimeve të temperaturës lidhet me faktin se materiali do të përdoret në kushte të jashtme dhe do të jetë i ekspozuar drejtpërdrejt ndaj kushteve atmosferike.

4. *Lëndë e sharruar druri 1.5 cm*: Lënda e sharruar e drurit parashikohet për përdorim në elemente të konstruksionit dhe/ose bazamentit të çatisë, ku është e nevojshme që materiali të ketë qëndrueshmëri dimensionale dhe karakteristika të përshtatshme për montim. Kërkesa që druri të jetë i stazhionuar dhe me lagështi të përshtatshme synon të kufizojë deformimet, tkurrjen dhe zgjerimin e materialit pas montimit, të cilat mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e shtresave të çatisë dhe në cilësinë e punimeve të izolimit. Përfundimi i materialit me kalbje, myk, dëmtime biologjike, çarje të mëdha ose deformime të theksuara është i nevojshëm për të garantuar që elementi i drurit të jetë në gjendje të përshtatshme për përdorimin e parashikuar dhe të mos krijojë probleme në shtresat e tjera të konstruksionit. Këto karakteristika janë të nevojshme për të ruajtur integritetin e tjegullës dhe funksionin e saj mbrojtës gjatë jetëgjatësisë së përdorimit.

Në tërësi, kërkesat teknike të përcaktuara janë orientuar drejt sigurimit të materialeve të përshtatshme për punime izolimi, riparimi dhe mirëmbajtjeje të çative, me karakteristika që i përgjigjen kushteve reale të përdorimit. Parametrat e kërkuar synojnë të garantojnë që materialet të kenë përshtatshmëri funksionale, qëndrueshmëri, rezistencë ndaj lagështirës dhe kushteve atmosferike, si dhe jetëgjatësi të arsyeshme të ndërhyrjeve, duke shmangur përdorimin e materialeve me defekte ose karakteristika të pamjaftueshme teknike.

NJËSIA E PROKURIMIT